



Planuar / Diturat Propozim / Pradalo Recep / Detyruar	31-12-2021	viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	No / Prok Br / Proc Proc No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	6489/2021		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1062/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Jeton Koca, kryetar, dhe Ardita Haxhnikaj - Demi, Arben Mehmeti- anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.861/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën A.nr.31/2020, të datës 13.02.2020, të parashtruar nga ankuesja nga Prishtina, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike, "kërkesës nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nen paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 31.12.2021, mori këtë;

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.31/2020, e datës 13.02.2020, e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 13.02.2020, ka parashtruar aneksen me numër protokollit 333/2020, të regjistruar me numër A.nr.31/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.12-14/112/02-296405/19 të datës 05.12.2019 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.02.2020, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë të Njësia për Burime Njerëzore pranë Komunës së Prishtinës. Njësia e Burimeve Njerëzore, në këtë rast nuk ka dorëzuar përgjigje në kërkesë, dhe rrjedhimisht nuk ka bashkëpunuar me Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin

Civil të Kosovës, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesja të njëjtën kohë ka hapur konflikt administrativë në Gjykatë Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit A.nr.861/2020 ka obliguar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos lidhur me ankesën A.nr.31/2020, të datës 13.02.2020 të parashtruar nga ankuesja

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 333/2020, të regjistruar me numër A.nr.31/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 05.12.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimin e datës 04.09.2019; Vendimin e datës 01.01.2019; Vendimin e datës 25.06.2019; Vendimin e datës 10.06.2019; Vendimin e datës 18.03.2019; Vendimin e datës 12.10.2018; Vendimin e datës 01.03.2018; Vendimin e datës 22.04.2015; Vendimin e datës 28.12. 2015; Vendimin e datës 13.03.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa A.nr.31/2020, e datës 13.02.2020, e parashtruar nga ankuesja

është e pa bazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës Nëpunëse e Ndihmës Sociale. E njëjta, nga ky pozicion, me datë 22.04.2015 përmes Vendimit 01nr.119-86737 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës është caktuar ushtruese e detyrës së Udhëheqësit të Shërbimeve të Ndihmave Sociale -Njësia Qafa. Të njëjtës i është vazhduar ushtrimi i detyrës në pozitën përkatëse me vendimin 01nr.119-13977 të datës 28.12.2015, Vendimin 01nr.112/03-0054325/17 të datës 13.03.2017, Vendimin nr.14-112/02-0050791/18 të datës 01.03.2018, Vendimin nr.14-112/02-151265/18 të datës 25.06.2018, Vendimin nr.14-112/02-248137/18 të datës 12.10.2018, Vendimin nr.14-112/02-6551/19 të datës 10.01.2019, Vendimin nr.14-112/02-61692/19 të datës 18.03.2019, Vendimin nr.14-112/02-0148009/19 të datës 10.06.2019, Vendimin nr.14-112/02-217048/19 të datës 04.09.2019.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se për shkak të ushtrimit të detyrës së Udhëheqësit të Skemave të Ndihmës Sociale, për me shume se gjatë (6) vjet, me performancë të lartë dhe pa asnjë vërejtje nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, si dhe duke marr parasysh përgatitjen e saj profesionale i ka plotësuar kushtet për emërim ex lege në pozitën përkatëse, gjegjësisht në pozitën e Udhëheqësit të Skemave të Ndihmës Sociale.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka analizuar legjislacionin e aplikueshëm në kohën kur ankuesja është caktuar ushtrues i detyrës të Udhëheqësit të Skemave të Ndihmës Sociale, respektivisht dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, nenin 30 ku përcaktohet se: 1. *Nëpunësit civilë, me*

urdhër nga eprori, janë të detyruar që përkohësisht ta zëvendësojnë një koleg i cili mungon ose ta plotësojnë një vend të lirë të punës, nëse veprimtaria e zakonshme e institucionit do të pengohej nga mungesa e nëpunësit civil: 4. Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se ushtruesi i detyrës sipas dispozitave të këtij ligji ka pasur karakter të përkohshëm, dhe qëllimi i këtij instituti ka qenë zëvendësimi i nëpunësit civil që mungon përkohësisht apo plotësimi i vendit të lirë të punës përkohësisht nëse veprimtaria e zakonshme e institucionit do të pengohej nga mungesa e nëpunësit civil. Sipas nenit 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, caktimi i ushtruesit të detyrës ka qenë në kompetencë të udhëheqësit me të lartë administrativ, dhe nuk ka mundur të zgjasë me tepër se 3 muaj. Andaj, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për njohjen e të drejtës për emërim në pozitën e Udhëheqësit të Skemave të Ndihmës Sociale për shkakun se e njëjta për një periudhë të caktuar ka ushtruar këtë detyrë nuk është i bazuar, sepse ankuesja ka qenë e caktuar vetëm përkohësisht si ushtrues i detyrës në atë pozitë. Për me tepër Kolegji konstaton se ushtrimi i detyrës së Udhëheqësit të Skemave të Ndihmës Sociale, nga ankuesja, me tepër se 3 muaj është bërë në kundërshtim me nenin 30 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.

Në kohën kur ankuesja ka parashtruar ankesë, çështja e avancimit në karriere të nëpunësve civil ka qenë e rregulluar me dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, ku me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se: 1. *Avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: 1.1. disponueshmërisë së pozitave të lira; 1.2. plotësimit të të gjitha kushteve të caktuara për atë pozitë; 1.3. kalimit të kohës së caktuar minimale; dhe 1.4. kalimit me sukses të testimit, dëshmimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale.* Ndërsa me dispozitat e Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 parashihet se avancimi në karriere behet në bazë të konkurrencës, dhe rrjedhimisht me nënparagrafin 1.4 të këtij neni ndalohet avancimi në mënyrë automatike. Bazuar në këto dispozita ligjore, Kolegji konstaton se pretendimi ankimor i ankueses për emërim në pozitën e Udhëheqësit të Skemave të Ndihmës Sociale, pa një procedurë të zhvilluar nga organi i punësimit sipas dispozitave të nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, dhe Rregullores Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1062/2021

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës;
- Arkivit të KPMSHCK-së